



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të "GOE Samire Osmani BI & Besim A Zejnullahu BI & Vlora A Ahmeti BI & Haxhi Gashi BI" të datës 02.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 29.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-4214-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e GOE "Samire Osmani BI & Besim A Zejnullahu BI & Vlora A Ahmeti BI & Haxhi Gashi BI" të datës 02.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 29.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-4214-2-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 29.05.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

GOE "Samire Osmani BI & Besim A Zejnullahu BI & Vlora A Ahmeti BI & Haxhi Gashi BI" (tutje "parashtruesi") me datë 02.06.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. prokurimi 616-24-4214-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë parashtruar dhe janë shqyrtuar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 - “OE DOCTOR EXTERMINTOR DDD & DDD nuk posedon nje deklarate te tille (deklarim me shkrim nga OE mbi realizimin e fazes brenda kohes se kerkuar)”.

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se te përshkrimi i projektit në kuadër të specifikave teknike është përcaktuar se “Projekti është paraparë të kryhet në gjashtë faza* me një interval kohor mes tyre prej 7-14 ditë nga dita e përfundimit të fazës paraprake (me mundësi të shkurtimit ose zgjatjes se këtij intervali 14 ditor varësisht nga situata epidemiologjike). Realizimi i nje faze duhet te kryhet brenda afatit prej 4 - 5 diteve pune (deklarim me shkrim nga OE mbi realizimin e fazes brenda kohes se kerkuar) me qëllim që të arrihet mundësia e eliminimit edhe te atyre insekteve që do të zhvillohen nga forma e tyre larvoore në ndërkohë, që do të thotë se nëse merret parasysh edhe koha tjetër e nevojshme për përgatitje adekuate i tërë projekti do të zgjasë afër katër (4) muaj, gjatë një viti”. Parimisht një kërkesë e tillë ka pasur mundësi që të përcaktohet edhe në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional në dosjen e tenderit. Mirëpo duke qenë se është parashtruar si kërkesë në këtë formë, komisioni vlerësues ka pasur mundësinë që të kërkoj sqarime shtesë nga tenderuesit në kuptim të nenit 72 të LPP. Në këtë kuptim pretendimi është i bazuar pjesërisht.

Pretendimi nr. 2 - “Grupi i OE DOCTOR EXTERMINTOR DDD SH.P.K & DDD SH.P.K nuk kan sjellur dëshmi se automjetet e tyre jane te paisura me GPS, pra nuk kane deshmuar me Platforme te monitorit. POASHTU NE NENIN 1 TE KONTRATES QE KANE OFRUAR (kontrata me TMS Mobile) SHKRUAN se GPS DO TE INSTALOHEN, PRA ME KETE DESHMOHET SE AUTOMJETE NUK KANE TE INSTALUAR GPS. Ndersa ne DT ne ANEKSIN NUMER 7 PIKA 4, SHKRUAN SE ;AUTOMJETJET DUHET TE JENE TE PAISURA ME GPS MONITORUES”.

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se në ofertën e tenderuesit të rekomanduar është bashkëngjitur një kontratë për marrjen me qera të pajisjeve GPS dhe shërbimeve të ndërlidhura. Kështu është dëshmuar se tenderuesi në rast të shpërblimit me kontratën që synohet të lidhet nga ky aktivitet i prokurimit, makineritë përkatëse do të jenë të pajisura me GPS sipas DT. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 3 - “Grupi i OE DOCTOR EXTERMINTOR DDD SH.P.K & DDD SH.P.K nuk ka dorzuar Ankesin 7 te DT siq eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit mirepo ka doruzar nje LISTE TE PAISJEVE jo sipas kriterëve te DT-se. Pra GO nuk e ploteson kete kriter te percaktuar ne FDT”.

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se në aneksin 7 të dosjes së tenderit është përcaktuar si në vijim:

Aneksi 7. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM			
(Ky Aneks është obligativ qe të plotësohet dhe ti bashkëngjiten dëshmitë e kërkuara ne FTD)			
PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM PËR PROJEKTIN ME TITULL: 34 Dezinsektimi hapësinor i komunës se Prishtinës- RITENDER			
Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Numri identifikues i paisjes

- Pra aneksi 7 i DT është obligativ që të plotësohet dhe të bashkangjitet me ofertë. Nga administrimi i ofertës së tenderuesit fitues është gjetur se i njëjti ka dorëzuar listat e makinerive mirëpo nuk ka plotësuar aneksin 7 të dosjes së tenderit respektivisht nuk ka bashkangjitur listën e pajisjeve në formën e përcaktuar përmes formularit të dosjes së tenderit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi nr. 4 - *“GO DOCTOR EXTERMINTOR DDD SH.P.K & DDD SH.P.K KA DORZUAR METODOLOGJINE E PUNES MIRPO NUK KA DORZUAR PLANIN DINAMIKE MBI REALIZIMIN E SHERBIMEVE”.*

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se ky pretendim ankimor i referohet kërkesë në DT të formuluar si në vijim:

4.Operatori Ekonomik duhet te dorëzoj metodologjine e punës, planin dinamik mbi realizimin e sherbimit (bazuar ne specifikimin teknik ne aneksin 1.)	4. Përshkrimi i detajuar i Metodologjisë se punës.
--	--

- Nga administrimi me ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se i njëjti ka dorëzuar një dokument me titull “Dezinsektimi hapësinor-Metodologjia”. Por në të këtë dokument nuk është evidentuar askund planifikimi dinamik për realizimin e shërbimeve sipas aneksit 1 të DT. Prandaj pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr. 5 - *“Ne Letren Standarde per tenderuesin e Eliminuar te cilen kemi pranuar nga ju si AK me date 29.05.2024 nje nga arsyetimi per eliminim eshte si ne vijim: -Ju si GOE-ik Po ashtu ,njejte keni vepruar edhe me kerkesen tjetër pika 4.Leja per Import te produkteve Biocide .- Dëshmi e kërkuar .4-Kopja elejes per import te produkteve biocide preparatet duhet te jene konform lejes se importit .Anetari I-re ,II-te dhe anetari III-te i GOE nuk e kan dorzuar me oferte deshmit se posedojne Lje per import te produkteve biocide nga MMPH Me kete arsyetim ju keni perdore standare te dyfishta ne vlersimin e oferatve pasiqe ju GOE te cilin e keni shpall si te pergjegjshem dhe e keni shperblyer me kontrate kane mungese te Lejes per importim te produkteve biocide nga MMPH. Ne oferten e tyre kane ofruar Lejen per import te produkteve biocide vetem njeri nga anetaret e grupit DOCTOR EXTERMINTOR DDD SH.P.K, ndersa anetari i dyte i grupit DDD SH.P.K nuk ka ofruar asnje Leje importi”.*

- Lidhur me këtë pretendim, fillimisht është gjetur se arsyet sipas të cilave parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm janë evidentuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- ❑ Ju si GOE-ik nuk keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale Neni 7.1 & 7.2 Përshtatshmëria profesionale: **pika 3.Operatori Ekonomik duhet te jetë i licencuar nga MBZHR për kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit të Republikës së Kosovës.** - Dëshmia e kërkuar: 3. *Kopja e licencës valide.*, Ju si GOE-ik me rastin e dorëzimit të ofertës për këtë pikë nuk keni dorëzuar Licencën siç është kërkuar në DT dhe njoftim për kontratë. Anëtari III-të i GOE-ik ka dorëzuar licencën me nr Ref. 04.5-558/23 me afat te skaduar (skadimi i licencës është me datë 03.05.2024). Po ashtu edhe anëtari IV-të i GOE-ik nuk ka dorëzuar me oferte dëshmitë sipas kërkesës 3 nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi qe posedon licence nga MMPH.
- ❑ Ju si GOE-ik Po ashtu, njëjtë keni vepruar edhe me kërkesën tjetër; **Pika 4.Leja për importim të produkteve biocide nga MMPH** - Dëshmia e kërkuar: 4. *Kopje e Lejes për importim të produkteve biocide preparatet duhet të jenë konform lejes së importit.* Anëtari i I-rë, II-të dhe anëtari i III-të i GOE-ik nuk kanë dorëzuar me oferte dëshmitë se posedojnë Leje për import të produkteve biocid nga MMPH.
- ❑ Ju si GOE-ik Po ashtu nuk keni vepruar konform kërkesave të DT-se kërkesat e përshtatshmërisë profesionale **pika 5.Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO standard 9001 2015, 14001 2015, 45001 2018.** - Dëshmia e kërkuar -5. *Kopja e certifikatave - valide dhe te noterizuara.*, Anëtari i III-të dhe IV-të të GOE-ik nuk kanë dorëzuar fare dokumentacionin e kërkuar për këtë pikë të kërkesës. Andaj për arsye të cekura më lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit.

- Nga formulimi i pretendimit ankimor të parashtruesit është gjetur se parashtruesi parimisht nuk i konteston arsyet për të cilat i njëjti është gjetur si tenderues i papërgjegjshëm mirëpo vetëm konsideron se tenderuesit nuk janë trajtuar të barabartë për arsyen se edhe oferta e tenderuesit fitues nuk është e përgjegjshme sipas pretendimeve të parashtruesit. Nga ky kënd i vështrimit është gjetur se pretendimet ankimore të parashtruesit kundër fituesit parimisht janë gjetur si të bazuara respektivisht si pjesërisht të bazuara. Pra argumenti se tenderuesit nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë nuk është aspak i saktë apo i bazuar. Prandaj edhe pretendimi ankimor si i tillë është gjetur se është i pabazuar.

Pretendimet ndaj tenderuesve të tjerë - parashtruesi ka prezantuar disa pretendime edhe ndaj tenderuesve të tjerë të pasuksesshëm dhe/apo të eliminuar në këtë aktivitet të prokurimit. Mirëpo duke qenë se të njëjtit nuk janë shpallur si tenderues të suksesshëm dhe njëkohësisht vet parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm, parashtruesi nuk ka demonstruar asnjë interes juridik apo material nga këto pretendime respektivisht nuk ka arritur që të argumentoj se është palë e interesuar në raport me këto pretendime në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP ku përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.06.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.